

## Procesverbal

I mbajtur me anëtarët e komisionit për shqyrtimin e propozimeve që vijnë nga ana e qytetarëve, institucioneve, shoqatave, kryesive të fshatrave, për dhënien e shpërblimeve „Emblema e Artë“, „Skënderbeu“ dhe mirënjohjen „13 Qershori“.

**Bexhet Kuçi - kryesues**  
**Ilir Voci -anëtar**  
**Labinot Halitjaha - anëtar**  
**Antigona Zyba -anëtare**  
**Sejdi Elezi- anëtar**

**Në takim munguan:**

**Mimoza Bajraktari - anëtare**  
**Adem Bytyqi - anëtar**

**Mbledhjen e hapi kryesuesi i komisionit z.Bexhet Kuçi i cili konstatoi që ka kuorum të mjaftueshëm për të filluar takimin.**

**Kryesuesi** - Për çmimin „Emblema e Artë“ propozimi ka ardhë nga Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj për Gafurr Elshanin. Kryesuesi lexon biografinë e Gafurr Azem Elshanit dhe hap debatin. Nuk ka debat. Kryesuesi e hedh në votim propozimin për Gafurr Elshanin që t'i ndahet çmimi „Emblema e Artë“.

**Unanimisht Miratohet**

**Kryesuesi** - për çmimin „Skënderbeu“ propozimi ka ardhë nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së, ku bëhet fjalë për dy dëshmorë, dëshmorin Xhavit Kelmendi dhe dëshmorin Naser Kelmendi. Hap debatin. Pasi nuk ka debat i hedh në votim propozimet që çmimi „Skënderbeu“ t'i ndahet dëshmorëve Xhavit Kelmendi dhe Naser Kelmendi.

**Unanimisht Miratohet**

**Kryesuesi** - për çmimin Mirënjohja „13 Qershori“ kemi 10 kërkesa, ku nga 10 kërkesat 7 janë postmortum.

**Kryesuesi** - e hedh në votim që të tërhiqet propozimi për Osman Cikaqin me arsyetimin që ka marrë mirënjohje në vitin 2018.

**Unanimisht Miratohet**

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin që çmimi „13 Qershori“ të ndahet për: Sylejman Kodra, Osman Krasniqi, Qemajl Cikaqi, Kadri Berisha, Agim Durak Kololli, Agim Ibrahim Zenelaj, Ibrahim Melit Zajmi, Ramadan Nebih Hoti dhe Ismet Xhemajli Bylykbashi.

**Unanimisht Miratohet**